



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

23 shkurt 2022

SCC-08-0275

*Paditësit*

**M J Ll**

*Përfaqësuar nga A Q. V, av nga Prishtina.*

*Kundër*

*Të paditurat*

**1. P K-E F K**

**2. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, pas seancës dëgjimore të datës 23 shkurt 2022, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

**1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit M J.**

**2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tij kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 24 tetor 2008, paditësi parashtroi në Dhomën e Posaçme padi për anulimin e kontratave të shitjes nr. 612/66 dhe 613/66 që të dtja të datës 25 mars 1966, të nënshkuara në mes të paraardhësit të paditësit J T. T prej Ll si shitës dhe K “K-E” nga F K, që të dy kontrata të lidhura në kundërshtim me nin 103 të LMD dhe nenin 8a të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për qarkullimin pasurive të patundshme, (RS-GZ nr. 28/77), të anulohen dhe të detyrohet e paditura të ia kthej te drejtën e pronesis dhe posedimit në parcelën kadastrale nr. 1461 ne sip. Prej 1.30,15 e regjistruar në fletën poseduese nr. 114 dhe parcelën kadastrale nr. 385 në sip, prej 1.24,71 ha e regjistruar në fletën poseduese 114 e që te dyja ne sipërfaqe të përgjithshme prej 2.54,86.

Në mbështetje të padisë paditësi ka dorëzuar, autorizimin për përfaqësim, njoftimin e datës 17 shtator 2008 bërë AKP-së për paraqitjen e padisë, kontratat e shitblerjes së patundshmërisë nr. 612/66 dhe 613/66 të vërtetuara në Gjykatën Komunale në Prishtinë që të dyja në kopje.

Me 18 nëntor 2008, përfaqësuesi i palës kërkoi zgjatjen e afatit për tu përgjigjur në urdhrin e gjykatës për plotësimin e padisë të datës 12 nëntor 2008.

Me 11 mars 2008, paditësi dorëzoi një parashtrësë me të cilat dorëzoi dëshmi shtesë në mbështetje të padisë dhe ndër të tjera e njoftoi gjykatën se e tërheq padinë në lidhje me ngastrën kadastrale nr. 1461 në vendin e quajtur livadhe me sip, prej 1.30,15 ha dhe se mbetet pranë padisë dhe kërkesë padisë në lidhje me ngastrën kadastrale nr. 385 me sip, prej 1.24,71 ha në vendi e quajtur te kisha fleta poseduese nr. 90 ZK Ll. Në mbështetje të kësaj parashtrëse përfaqësuesi dorëzoi një kopje të padisë të datës 11 dhjetor 1993 drejtuar Gjykatës Komunale ne Prishtinë, një kopje të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme të datës 19 nëntor 1969, vërtetuar ne Gjykatën Komunale në Prishtinë nr. 1008/69, vendimin nr. 24315 të datës 14 dhjetor 1963 në kopje dhe procesverbalin ( pothuajse i pa lexueshëm në kopje).

Me 13 prill 2010, përfaqësuesi i paditësit dorëzoi parashtrësën në përgjigje të urdhrin të gjykatës të datës 15 shkurt 2010, në mbështetje të kësaj parashtrëse dorëzoi, përkthimin në gjuhën angleze të procesverbalit dhe kontratës për mbajtjen e përjetshme dhe një deklaratë të datës 04 prill 2010 të nënshkruar nga avokati.

Me 10 prill 2010, përfaqësuesi i paditësit dorëzoi një parashtrësë për plotësimin e lëndës me prova të tjera sipas urdhrin të gjykatës të datës 15 shkurt 2010, në mbështetje të saj dorëzoi një kopje të autorizimit si dhe kërkesën e paditësit drejtuar prokurorisë publike komunale në Prishtinë me datë 28 shtator 1992.

Me 31 tetor 2017, Komuna e Graçanicës dorëzoi historiatin e parcelës të kërkuar sipas urdhrin të gjykatës të datës 16 tetor 2017 e cila ndër të tjera deklaroi se sa i përket parcelës kadastrale P-385-0 me sip, prej 210 m<sup>2</sup> ZK Ll, pas shqyrtimit të librave kadastral të cilat i posedojnë që nga viti 2000 e deri më tani kanë konstatuar se kjo parcelë ne bazë të kontratës për dhurim VR. Nr. 8671/2004 nga 29.12.2004 nga z. Dj C (D ) ½ i ka kaluar në emër të Dj D (Q) ½. Dhe se ky ndryshim është regjistruar në librin e ndryshimeve me nr. Rend. 75 për vitin 2004, pastaj në bazë të kontratës për shkëmbimin e parcelave Vr. nr. 7507/2005 nga 22 shtator 2005, ajo e ndryshoi pronësinë dhe atë nga z. Dj S (D) ½ kaloi në emër të tij, ky ndryshim është regjistruar në lirin e ndryshimeve me nr. rend. 79 për vitin 2005. Po ashtu deklaroi se sa i përket parcelës kadastrale nr. P-1461-0 me sip, prej 13015 m<sup>2</sup> ZK Ll, pas shqyrtimit të librave kadastrale, të cilat i posedojnë që nga viti 2000 deri më tani, kemi konstatuar se kjo parcelë në bazë të kontratës për dhurim Ov. Nr. 374/2012 nga 10 dhjetor 2012 ka kaluar nga z. J M (T) në emër te z. J Z (M) , dhe se dhe sot kjo parcelë është e regjistruar në emër të tij, ky ndryshim është regjistruar në librin e ndryshimeve me nr. rend. 174 për virin 2012, po ashtu ka bashkangjitur certifikatën aktuale në Kadastër për parcelat kadastrale P-385-0 dhe P-1461-0 ZK Ll.

Me 08 nëntor 2017, e paditura AKP dorëzoi mbrojtjen e saj e cila ndër të tjera deklaroi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. E paditura pohoi se padia është parashtruar në kundërshtim me parimin procedural legitimacio ad causam, i cili ka të bëjë me legjitimitetin real aktiv të palës. Po ashtu e paditura pohoi se paditës në padinë e tij nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën mbështetet kërkesa, në rastin konkret paditësi ka dështuar të paraqes dëshmi dhe prova relevante për të bërë të besueshme kërkesën e tij. Me tej e paditura pohoi se paditësi ka kërkuar anulimin e kontratës mbi shitblerjen Leg, nr. 613/66 e datës 25 mars 1966 dhe dorëzimin e patundshmërisë në posedim me arsyetimin se lidhja e kontratës është bërë nën presion dhe pa vullnetin e lirë të paraardhësit të tij, por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi lidhur me ato rrethana për veprime të dhunshme të supozuara.

Me 15 nëntor 2017, përgjigja e kadastrit të Komunës së Graçanicës ju dërgua palëve për informim.

Me urdhrin e datës 15 nëntor 2017, mbrojtja e AKP-së iu dërgua paditësit/përfaqësuesit, sipas flete kthesës avokati ka pranuar raportin e kadastrit dhe mbrojtjen e AKP-së me 16 nëntor 2017, por nuk dorëzoi asnjë përgjigje.

Me 08 shkurt 2022, Dhoma e Posaçme, në këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i palës së paditur AKP, ndërsa nuk ka prezantuar pala paditëse dhe i autorizuari i tij, të cilët kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt. Gjyqtari kryesues nw fillim tw seancws njoftoi se me 04 shkurt 2022, përfaqësuesi i paditësit av A Q. M ka dorëzuar një parashtrësë me të cilën e ka njoftuar gjykatën se paditësi M J ka ndërruar jetë dhe se nuk ka informacion tjetër se nuk ka mundur të kontaktoj me pasardhësit e tij, pasi që disa janë në Slloveni e disa në Serbi. Po ashtu gjyqatri kryesues pohoi se përmes kësaj parashtrëse është njoftuar nga përfaqësuesi i paditësit se pasardhësit e paditësit ende nuk e kanë bërë shqyrtimin e trashëgimisë dhe si rrjedhojë ka kërkuar prej gjykatës me shty seancën dëgjimore, për një kohë të pa caktuar. Përfaqësuesi i të paditurës AKP, deklaroi se në lidhje me pjesën e padisë për shtyrjen e seancës, konsideron se në bazë të rrethanave gjykata të marrë vendim për ndërprerjen e procedurës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit M J.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet:*

*a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

*Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.*

Me 25 janar 2022, paditësit M J gjykata i ka dërguar urdhrin për seancë dëgjimore, i cili urdhër është pranuar me 27 janar 2022, nga përfaqësuesi i paditësit.

Me 04 shkurt 2022, Gjykata ka pranuar nga përfaqësuesi i paditësit M J, A Q. V kërkesën për shtyrjen e seancës për shkak të vdekjes së paditësit. Me këtë kërkesë gjykata është njoftuar se M J ka vdekur kurse nga pasardhësit e tij ka informata se ende nuk e kanë bërë trashëgiminë dhe se asnjëri prej tyre nuk më ka autorizuar për të vazhduar përfaqësimin e tyre në këtë procedurë.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar